

Nr. 3543 prot

dt. 1. 3. 2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQERIA "COLOSSEO KONSTRUKSION" Sh.p.k
SHKODER-ALBANIA

Shkoder me date 01.03.2021

Lenda: Formulari i Ankeses



Drejtuar : BASHKISE SHKODER

Bashkengjitur po ju dergojme Formularin e Ankeses per Ankandin Publik dhe te gjitha dokumentat e tjere qe provojne se kriteret e vendosura nga ana e Autoritetit Shites jane te padrejta, ne lidhje me ankandin qe organizohet me date me date 09.03.2021 nga Bashkia Shkoder me objekt "BASHKIA SHKODER SHET ME ANKAND AKSIONET E KLUBIT TE FUTBOLLIT "VLLAZNIA" SH.A. NE MASEN 100 % " me fond fillestar 50 794 000 (Pesedhete milion e shtateqind e nentedhete e kater mije) lek..

Per "COLOSSEO KONSTRUKSION" Sh.p.k

Perfaqesues

Valter Fushaj

Shtojca 9

FORMULARI I ANKESËS PËR ANKANDIN PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti Shites X –BASHKISE SHKODER

Ankesë drejtuar: Agjencia e Prokurimit Publik

Seksioni I. Identifikimi i Ankimuesit

Shoqeria "COLOSSEO CONSTRUCTION" sh.p.k.

Adresa : Lagja "3 Heronjt", Rruga Marin Bicikemi, Shkoder

Shkoder - Shqiperi 4001 Kodi Postar/Kodi Zip

00355 68 20 46 466 Nr. Telefoni

042225000 Nr. Faksi

pjeroscutari@yahoo.com E mail

VALTER FUSHAJ – PERFAQESUES ME PROKURE

Emri dhe pozicioni i zyrtarit të autorizuar që plotëson ankesën (ju lutem, shtypeni)

Firma e zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita) **01.03.2021**

00355 68 20 46 466

Nr. Telefoni (duke përfshirë prefiksin e zonës)

Nr. Faksi (duke përfshirë prefiksin e zonës)

Seksioni II. Informacion për Procedurën

1. Numër Identifikimi

Plotësoni numrin e references te përcaktuar ne dokumentet e ankandit, duke përfshirë llojin e procedurës së përdorur për ankandin në fjalë (psh, Kërkesë për Propozime(KP), Procedurë e Hapur(PH), Procedurë e Kufizuar(PK), Procedurë me Negociim(PN), Shërbim Konsulence (SHK), Konkurs Projektimi (KP).

PROCEDURE E HAPUR



2. Autoriteti Shites

Emri i autoritetit shites që administron procesin e ankandit publik

BASHKIA SHKODER

3. Vlera e shpallur ne Ankand

(shuma e shprehur në shifra dhe fjalë)

50 794 000 (Pesedhjetë milion e shtateqind e nentëdhjetë e kater mijë) lek.

4. Objekti i Ankandit

Përshkrim i shkurtër i objekteve/mallrave/shërbimeve që shiten.

**BASHKIA SHKODER SHET ME ANKAND AKSIONET E KLUBIT TE FUTBOLLIT "VLLAZNIA" SH.A. NE MASEN
100 %**

5.Afati Përfundimtar për Dorëzimin e Ofertës

Afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave.

09.03.2021, ora 10.00

Data (viti/muaji/dita)

6. Data e shpalljes se fituesit

25.02.2021 (Data e blerjes se dokumentave te ankandit)

Data (viti/muaji/dita) nëse zbatohet

Seksioni III. Përshkrimi i ankesës

1. Baza Ligjore e Ankesës

Ligji nr.9874 date 14.02.2008 "Per ankandin Publik", i ndryshuar

VKM nr.1719 date 17.12.2008 "Per miratimin e rregullave te ankandit publik"

VKM nr.33 date 19.01.2011

VKM nr.692 date 18.10.2011

VKM nr.308 date 10.04.2013

Dokumentat e Ankandit



Vendimi i Keshillit Bashkise Shkoder nr.54 date 27.11.2020

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

2. Deklaratë e Hollësishme e Fakteve dhe Argumenteve

Shoqëria "COLOSSEO KONSTRUKSION" sh.p.k., është subjekt juridik i regjistruar pranë organeve tatimore që në vitin 2013, me nr.Nipti K 37426001 Q, ndër të tjera me aktivitet administrimit dhe menaxhimit të klubeve sportive.

Bazuar në aktivitetin e saj dhe conform publikimit të bërë nga Bashkia Shkoder në buletin e njoftimeve publike nr.21 date 15.02.2021 për objektin "BASHKIA SHKODER SHET ME ANKAND AKSIONET E KLUBIT TE FUTBOLLIT "VLLAZNIA" SH.A. NE MASEN 100 %", shoqëria jone ka shprehur interesin për të marrë pjesë në këtë procedurë të hapur ankandi.

Në funksion të saj me date 25.02.2021 kemi paraqitur kërkesën për të blerë dokumentat e ankandit sipas kushteve të vendosura paraprakisht nga ana juaj. Po ashtu kemi bërë edhe pagesën përkatëse dhe njëkohësisht kemi pajisur me dokumentat e ankandit.

Gjatë përgatitjes së dokumentacionit të kërkuar nga ana juaj, konstatojmë se janë vendosur kritere për kualifikim që janë të paqarta dhe njëkohësisht në kundërshtim me parashikimet e dispozitave ligjore në fuqi.

Sa me sipër në përputhje me nenin 42 të ligjit nr. 9874 date 14.02.2008 "Për ankandin Publik", i ndryshuar po paraqesim kundërshtimet tona, duke ju parashtruar si më poshtë vijon:

1. Bashkia Shkoder në cilësinë aksionerit të vetëm të klubit të futbollit "Vllaznia" sh.a., ben administrimit e jashtëzakonshëm të tij nëpërmjet vendimarrjeve përkatëse të Keshillit të Bashkise, si aksioner dhe ortak de juro dhe de facto i klubit të futbollit "Vllaznia" sh.a. Në përputhje me kompetencat e tij Keshilli I Bashkise Shkoder me date 27.11.2020, nëpërmjet vendimit nr.54 ndër të tjera ka vendosur:

-Miratimin për shpalljen për shitje të 100% të aksioneve që Bashkia Shkoder zoteron si aksionere e vetme në Shoqërinë Klubi I Futbollit "Vllaznia".

Në pikën 3 të këtij vendimi është përcaktuar qartë se: **"Forma e shitjes së aksioneve që zotërohen nga Bashkia Shkoder në Shoqërinë Klubi I Futbollit "Vllaznia", të bëhet nëpërmjet procedurës konkurruese: Procedure e Hapur Standart e Ankandit, sipas dokumentave standarte tip të ankandit, bashkangjitur këtij vendimi.**

Duke ju referuar kesaj vendimarrje, e cila ka karakter detyrues për Bashkinë Shkoder, rezultojnë se Keshilli I Bashkise e ka përcaktuar qartë procedurën që duhet të ndiqet për shitjen e aksioneve të Klubit të Futbollit "VLLAZNIA" por nga ana tjetër ka përcaktuar qartë edhe kriteret që duhet të vendosen paraprakisht për çdo subjekt të interesuar për blerjen e këtyre aksioneve.

Në referim të kesaj vendimarrje dhe në referim të përcaktimeve ligjore për ankandin publik, procedurën e hapur të zhvillimit të tij rezultojnë që Bashkia Shkoder ka vendosur kritere në kundërshtim me ligjin, diskriminuese dhe njëkohësisht për të favorizuar eventualisht ndonjë subjekt të interesuar.




Neni 29 I ligjit 9874 date 14.02.2008 "Per ankandin Publik", i ndryshuar percakton qartesisht se cilat jane kriteret qe duhet te vendosen ne procedure e hapur te ankandit public dhe konkretisht:

Neni 29

Kriteret dhe kushtet e kualifikimit të kandidatëve ose ofertuesve

1. Autoriteti shitës kualifikon në procedurat e ankandit çdo kandidat ose ofertues vetëm kur paraqet:

- a) formularin e sigurimit të ofertës për shumën dhe vlefshmërinë e kërkuar në dokumentet standarde të ankandit;
- b) vendimin e gjykatës për fitimin e personalitetit juridik;
- c) vërtetimin nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit;
- ç) certifikatën e regjistrimit në organin tatimor ose NIPT-in.

2. Autoriteti shitës, kur kërkohet informacion për ofertuesin rezident në një shtet të huaj, mund të kërkojë bashkëpunimin e autoriteteve përkatëse.

Ky parashikim ligjor I bere ne perputhje me natyren dhe qellimin e ankandit public eshte determinant per percaktimin e kushteve qe duhet te kete nje subjekt per te marre pjese ne nje ankand public procedure e hapur.

Nderkohe qe Bashkia Shkoder vendos kriteret ekstremisht te ekzagjeruara dhe ne kundërshtim me dispozitat ligjore duke mos pasur asnje arsytim logjik dhe ligjor per vendosjen e tyre.

Te gjitha kriteret e vendosura nga Bashkia Shkoder bien ndesh me qellimin qe ka ligji per ankandet publike:


Neni 1

Objekti dhe qëllimi

1. Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për realizimin e shitjes publike nëpërmjet procedurës së ankandit nga autoriteti shitës dhe mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të pjesëmarrësve në procedurën e ankandit.

2. Qëllime të këtij ligji janë:

- a) rritja e efikasitetit dhe efikasitetit në procedurat e ankandit publik, të kryera nga autoritetet shitëse;
- b) nxitja e pjesëmarrjes së blerësve në procedurat e ankandit publik;
- c) nxitja e konkurrencës ndërmjet blerësve;



ç) sigurimi i trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë

pjesëmarrësit në procedurën e ankandit publik;

d) sigurimi i integritetit, besimit publik dhe transparenca në procedurat e ankandit publik.

Si pasoje e kriterëve të vendosur nga ana juaj, ajo që konstatohet menjëherë është shkelja e nenit 1/c për nxitjen e konkurrencës nëpërmjet subjekteve të interesuara, pasi po të ishte bërë një verifikim paraprak në organet tatimore se cilat janë dhe sa është numri i bizneseve që kanë realizuar sponsorizime (përjashtues ato që janë ortak ose të angazhuar në një ekip tjetër të futbollit shqiptar) është shumë i vogël për të mos thënë nuk ekziston fare.

Vendosja e këtyre kriterëve nuk siguron trajtim të barabartë për të gjithë, pasi favorizon në mënyrë direkte subjektet e preferuar nga ana juaj.

Në pikë q të kërkesës për kualifikim është kërkuar që subjekti pjesëmarrës duhet të ketë kontrata, transaksione dhe eksperiencë në bashkëpunimin, financimin ose menaxhimin e klubeve sportive, shoqërive sportive të futbollit apo sporteve të tjera të ngjashme, minimalisht në tre vitet e fundit, pjesë e veprimtarisë të subjektit të publikuar në QKB.

Nëse është përcaktuar shprehja "Minimalisht", normalisht që të sqarohet edhe e kundërta e saj. Për "maksimalisht" deri kur është e lejueshme dhe e pranueshme për ju që të ekzistojë një eksperiencë e ngjashme. Pasi në intervertimin lateral të fjalës "Minimalisht", I bëj që të mos ketë ndonjë kufizim për periudhën se kur duhet të jetë realizuar eksperiencë e ngjashme.

Po ashtu është lënë në mënyrë evasive "përcaktimi i sporteve të ngjashme" duke mos sqaruar se cilin prej sporteve do të vlerësoj sitë e ngjashëm Bashkia Shkodër, apo thjeshtë do të bëj vlerësimin vetëm mbi bazën subjektive duke favorizuar subjektin e saj preferencial.

Është kërkuar që të paraqiten dokumentacione sponsorizimi në përputhje me legjislacionin tatimor, nderkohe që legjislacionin tatimor e kushtëzon ruajtjen e dokumentave kontabel tatimor për një periudhë 5-vjeçare. Duke sjellur përjashtimin automatik të subjekteve që kanë kryer sponsorizime në periudhë më të largët se 5 vite.

Përpilimi i dokumentave është bërë në mënyrë tendencioze duke të lënë pershtypje sikur janë vendosur në dem të ndonjë subjekti dhe jo në dobi të subjekteve të interesuara.

VKM nr. 308 datë 10.04.2013 e kësaj date përcaktuar qartë se :

dh) Kriteret dhe kushtet për pjesëmarrje, kualifikim dhe vlerësim të ofertës

Ky formular përmban listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, të kërkuar nga autoriteti shitës, për të drejtën për të marrë pjesë në procesin e ankandit, në përputhje me nenin 29 dhe 30 të LAP-së. Kandidatët apo ofertuesit e huaj, shtetet e të cilëve nuk lëshojnë dokumente të tilla, janë të detyruar të paraqesin, për të gjitha sa u thanë më sipër, një deklaratë me shkrim. Vërtetimi i lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR) do të jetë i barazvlefshëm me vendimin për fitimin e personalitetit juridik, përcaktuar në nenin 29 të LAP-së. Kriteri bazë i vlerësimit do të jetë oferta me çmimin më të lartë.



Edhe ne kete percaktim ligjor kuptohet qarte se qellimi I ankandit k ate beje vetem me njohjen e personalitetit juridik te subjektit pjesemarres, ligjshmerine e aktivitetit te tij dhe vendos si baze te shpalljes fitues **OFERTEN ME CMIM ME TE LARTE.**

Nuk eshte dhene as ndonje sqarim ne lidhje me fakin se cfare do te behet me detyrimet eventuale qe mund te kete SHOQERIA KLUBI I FUTBOLLIT "VLLAZNIA" SH.A. Ne menyre qe te mos kete pengesa dhe paqartesi ne nenshkrimin e kontrates mes fituesit te ankandit dhe Bashkise Shkoder.

Ne kushtet kur dokumentat e ankandit jane vendosur ne kundershtim me dispozitat ligjore, ne kushtet kur nga ana juaj jane bere shkelje flagrante te ligjit kerkojme nga ana juaj qe te beni ndryshimin e kriterëve te kualifikimit per proceduren e ankandit per objektin "BASHKIA SHKODER SHET ME ANKAND AKSIONET E KLUBIT TE FUTBOLLIT "VLLAZNIA" SH.A. NE MASEN 100 %", dhe te vendoset kriteret vetem ne perputhje me ligjin dhe vkm qe rreugullon aktivitetin e ankandeve publike.

Ne rast te kundert do ju drejtohem i organeve me te larta administrative ne fushen e aknadeve publike dhe atyre gjyqesore per te vene ne vend te drejtat tona legjitime te shkelura ne menyre flagrante nga ana juaj.

Seksioni IV. Kundërshtimi Paraprak ndaj Autoritetit Kontraktor

Kundërshtim quhet një ankesë e drejtuar drejtpërdrejt autoritetit shites. Bashkangjisni një kopje të çdo ankese me shkrim, duke përfshirë edhe përgjigjen, nëse ka një tillë.

1. Keni bërë ndonjë kundërshtim të tillë? Nëse po, atëherë specifikoni mënyrën e kundërshtimit (psh, me shkrim, nepermjet faksit, etj).

Po

Jo

2. Autoriteti shites Pranë të Cilit është bërë Kundërshtimi

Emri i autoritetit shites.

BASHKIA SHKODER

Emri dhe pozicioni i zyrtarit ndaj të cilit është bërë kundërshtimi.

NDAJ PERSONAVE QE KANE HARTUAR DOKUMENTAT E ANKANDIT (KRITERET PER PJESEMMARJE DHE KUALIFIKIM)

3. Natyra e Masës së Kërkuar Korrigjuese

Çfarë mase korrigjuese kërkoni?



1.PEZULLIMIN E PROCEDURES SE ANKANDIT

2.PRANIMIN E KERKESES SE PARAQITUR NGA SUBJEKTI ""COLOSSEO CONSTRUCTION" sh.p.k.

3.NDRYSHIMIN E DOKUMENTAVE TE ANKANDIT SIPAS KONSTATIMEVE TONA

4. Lista e Shtojcave

1.Ekstraktin e Qkb te subjektit ""COLOSSEO CONSTRUCTION" sh.p.k.

2.Dokumentin e perfaqesimit

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës për prokurimin, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe disa kopje shtesë, pranë: Agjencisë së Prokurimit Publik.


Një kopje e kësaj ankese duhet t'i dërgohet njëkohësisht autoritetit shites.

Nr. Faks:

E-mail: pjeroscutari@yahoo.com

Nenshkrimi dhe Vula e ankuesit

VALTER FUSHAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	K37426001Q
2. Data e Regjistrimit	26/12/2003
3. Emri i Subjektit	COLOSSEO CONSTRUCTION
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	16/12/2003
6. Kohëzgjatja	Nga: 16/12/2003
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Shkoder Shkoder SHKODER Godine banimi dhe sherbime 1 dhe 7 kat me 1 kat parking nentoke, Lagjja Tre Heronjte, Rruga Marin Biçikemi, Shkoder me nr. pasurie 7/612, 7/614, 7/1, 7/601, ne zonen kadastrale 8593
8. Kapitali	100.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	100,00
9. Objekti i aktivitetit	Tregti me shumice e pakice, import-eksport te artikujve te ndryshem ushqimore, industriale, bujqesore, pije freskuese dhe alkoolike, materiale ndertimi, inerte, parafabrikate, zyre konsulente ne fushen juridike, financiare, hartim e zbatim projektesh, agjensi komisionere si dhe ne fushen e transportit te mallrave dhe pasagjereve brenda dhe jashte vendit, etj.1.Kontraktimin dhe administrimin e lojtarëve futbolliste nëpërmjet blerjes dhe shitjes së TMS (Kartoni i lojtarit pranë FIFAs) nivel kombetar dhe ndërkombëtar.2.Dhënie e asistencës profesionale dhe juridike për negociim kontraktor apo transferim me futbollistë profesionistë brënda dhe jashtë vendit.3.Asistencë për shitblerje e aktiviteteve sportive. 4.Administrimi dhe menaxhimin e klubeve sportive të futbollit pas negociimit dhe përfundimit të procesit të privatizimit të klubeve apo shoqërive sportive. 5.Menaxhimi të drejtave televizive dhe reklamash në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar që kanë lidhje me sportin .6.Organizim të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

	<p>aktiviteteve të ndryshme me karakter sportive në rang kombëtar dhe ndërkombëtar.7.Tregtim me shumicë dhe pakicë të paisjeve ,produkteve apo suplementeve sportive nëpërmjet eksport-import.8.Ngritje apo krijim të një Akademie futbollit.9.Ushtrim aktiviteti në qendrat për kontrollin mjekësor të kapaciteteve fizike të sportistëve.10 Sipermarje për objektet sportive në formën e ndërtimit,privatizimit,marrjes apo dhënies me qira si dhe rikonstrukcionin e tyre.11.Shoqeria do të kryejë cdo aktivitet që lidhet me objektin e përcaktuar më lart.Konsulence ne fushen e drejtesise dhe ligjit duke perfshire pa u kufizuar ne konsulence juridike ,gjeresisht ne fushen e te drejtes tregtare,te drejtes civile,administrative,penale,puplike, te punes,financiare dhe bankare,familjares,kontratave dhe detyrimeve dhe te drejtes nderkombetare publike dhe private.Konsulence ligjore ne fushen e taksave,qeverisjes se korporatave,bashkimit dhe perthithjes se shoqerive tregtare,prokurimeve publike,koncesioneve dhe privatizimeve,pronesise intelektuale dhe te drejtave te autorit,negocim tregtar dhe kontrata si dhe konsulence ne te gjitha fushat e tjera te se drejtes ne pergjithesi.Sherbime avokatie dhe perfaqesimi ne gjykatat e te gjitha shkalleve si ne Gjykatat e Arbitrazhit ne Shqiperi dhe jashte saj.Konsulence juridike ne fushen e investimeve,zhvillimit te pasurive te pa luajtshme dhe tregjeve financiare. Aktivitet ne fushen e ndertimit. Zbatim, investim e projektim te ndertimeve civile, ekonomike, ndertime civile e turistike e rikonstrukcione te te gjitha llojeve, punime germime dheu. Ndertim i godinave shume kateshe polifunksionale. Kryerjen e te gjitha punimeve qe lidhen ne menyre te drejte per drejte ose jo me fushen e ndertimit.</p>	
10. Administratori/ët	Dedë Fushaj	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 04/07/2013	Deri: 29/03/2023
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	DedëFushaj	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 100.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	100,00	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) <i>*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)</i>	100,00
12.4 Komente (nëse ka)	
13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	
14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: COLOSSEO CONSTRUCTION E-Mail: pjeroscutari@yahoo.com Telefon: 042225000 Të Tjera: Depozitim i vendimit dt.16.04.2010 mbi shtesë statuti për shoqërinë "Colosseo Contruction " në fushën sportive .
15. Statusi:	Aktiv

Datë: 28/02/2021

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)



Vulosur elektronikisht nga
Qendra Kombëtare e Biznesit
Date:2021/02/28 13:26:19 +01:00
K37426001Q2021022813255979
2006

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra Kombëtare e Biznesit)

